

V E N D I M
NR.224, datë 13.4.2001

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE
TË DUHAN –CIGAREVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të ligjit nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Duhan-Cigareve, si institucion, shtetëror me statusin e personit juridik, publik, pa qëllim fitimi, që financohet nga buxheti i shtetit, në varësi të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, me qendër në Tiranë.

2. Numri i punonjësve të Agjencisë për vitin 2001, të jetë 10 (dhjetë) vetë, 1 (një) drejtor, 7(shtatë) specialistë dhe 2 (dy) punonjës ndihmës.

3.Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Duhan Cigareve emërohet nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

4. Specialistët dhe punonjësit ndihmës emërohen nga Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Duhan- Cigareve.

5.Paga e Drejtorit të Agjencisë të jetë sipas klasifikimit B3 të lidhjes I, të vendimit nr. 726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.”, ndërsa pagat e punonjësve të tjerë të jenë sipas lidhjes II-5, “Niveli i pagave për punonjësit e ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore” të po këtij vendimi.

Rregullat e hollësishme të strukturës, të numrit organik dhe të veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Duhan –Cigareve parashikohen në rregulloren e saj, e cila miratohet nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

6.Agjencia Kombëtare e Duhan- Cigareve ka për detyrë :

të ndjekë zbatimin dhe monitorimin e ligjit nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, në të gjitha aspektet e prodhimit, industrializimit, marketimit dhe tregtimit të duhanit dhe të produkteve të tij;

të mbështesë e të zbatojë politikat e qeverisë për zhvillimin e sektorit të duhanit dhe të produkteve të tij në Shqipëri;

të përcaktojë dhe të ndjekë zbatimin e standardeve që lidhen me duhanin dhe produktet e tij;

ç. të stimulojë prodhimin dhe eksportin e duhanit;

d. t’i propozojë Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, çdo vit, në fund të muajit tetor, masat që duhen marrë për sezonin e ardhshëm të kultivimit të duhanit;

dh. të propozojë kriteret për kultivimin, rajonizimin dhe strukturën varietore të duhanit;

e. të përgatisë dhe të botojë broshura për prodhimin, farërat, teknologjitë e kultivimit, strukturën varietore, industrializimin dhe tregtimin e duhanit dhe të produkteve të tij.

7. Me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit përcaktohet mënyra e administrimit të mjeteve të fondit duhan.

8. Fondi duhan përdoret për :

zhvillimin e veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Duhan–Cigareve;

prodhimin e farës së duhanit nga Instituti i Duhanit, Cërrik, për dhënie e saj falas kultivuesve të duhanit.

kryerjen e analizave të farërave dhe të materialeve duhanore;

ç. kryerjen e studimeve për rajonizimin e duhanit në shkallë vendi, në përputhje me kërkesat e industrisë përpunuese dhe të tregut;

d. nxitjen e punës kërkimore-shkencore, për krijimin e kultivarëve dhe të hibrideve të rinj, me qëllim përmirësimin e strukturës varietore në varësi të kërkesave të industrisë përpunuese dhe të tregut.

dh. studime, sipas politikave të caktuara të qeverisë, për zhvillimin e sektorit të duhanit dhe të produkteve të tij;

e. botime, seminare, simpoziume dhe veprimtari të tjera, që zhvillohen për duhanin dhe për produktet e tij, brenda dhe jashtë vendit.

9. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta